VENDIM
Nr. 513, datë 13.6.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 pika 1 shkronja "e", 16 pika 8, 20 pika 4, 22 pika 5, 24 pikat 1, 5 e 6, 30 pikat 1 e 6, 34 pika 5, 38 pika 1, 42 pika 5, 56 pika 1, shkronjat "a" e "dh", 65 pika 3 e 145 pika 3 të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HYRJEN E QËNDRIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

1. Të huajt, që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve të neneve 6 pika 1, shkronja "e" dhe 10 pika 2 të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 "Për të huajt", rast pas rasti, mund t'i kërkohet nga autoritetet e kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar paraqitja e një ose disa dokumenteve të mëposhtme:

a) Ftesa e garantit/ftuesit në Shqipëri;

b) Bileta/rezervimi për kthimin;

c) Dëshmia për akomodimin e mbështetur në prova;

ç) Leja e punës nëse hyn në Shqipëri për motive punësimi;

d) Mjetet financiare, shqiptare ose valutë e huaj, që mund të shkëmbehen në një agjenci këmbimi në Republikën e Shqipërisë, ose forma të tjera pagese, që pranohen në transaksionet tregtare në Republikën e Shqipërisë, si: çek, kartë krediti etj.;

dh) Dëshmia e mjeteve financiare nga subjekte financiare në Republikën e Shqipërisë, si: kontratë llogarie bankare, librezë depozitë etj., qoftë për periudhën e qëndrimit të synuar, ashtu dhe për kthimin në vendin e tij të origjinës ose periudhën kur do të qëndrojë transit në një shtet të tretë, në të cilin ai është i sigurt që do të pranohet ose provon se është në gjendje të përfitojë mjete të tilla në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, në shumën 30 (tridhjetë) euro për ditë qëndrimi dhe 15 (pesëmbëdhjetë) euro për të miturin;

e) Kartela origjinale e vaksinimit ndërkombëtar, kur i huaji vjen nga vende të prekura nga epidemi ose sëmundje, për të cilat legjislacioni shqiptar e kërkon.

Në rast se i huaji nuk është i pajisur me kartelë, njoftohen strukturat e specializuara të Ministrisë së Shëndetësisë, për të marrë së bashku masat e duhura, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Pas kontrollit të dokumentacionit në pikat e kalimit kufitar apo jashtë tyre, autoritetet kompetente kryejnë këto procedura:

a) Regjistrimin e të huajit kur hyn dhe del në mënyrë të ligjshme nga Republika e Shqipërisë sipas dokumentit të tij të udhëtimit;

b) Regjistrimin e të huajit, të cilit, për arsye të parashikuara në ligj ose në akte nënligjore, i refuzohet hyrja në territor;

c) Regjistrimin e të huajit, i cili hyn ose ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt";

ç) Regjistrimin në dalje të shtetasit të huaj që ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të parregullt ose në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt";

d) Regjistrimin e të huajit që kërkon azil në kufi;

dh) Evidentimin e masave administrative të vendosura ndaj të huajit sipas përcaktimeve në ligjin nr. 108/2013 "Për të huajt", në dalje nga Republika e Shqipërisë.

3. Shtetet, shtetasit e të cilave bëjnë përjashtim nga detyrimi i regjistrimit pranë autoritetit

përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku kanë vendosur vendbanimin, përcaktohen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME VIZË

A. Kritere të përgjithshme për t'u pajisur me vizë

1. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë me pasaportë diplomatike ose shërbimi, përcaktohen në aneksin nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë me pasaportë të zakonshme ose letërnjoftim, përcaktohen në aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me vizë, si dhe tarifat përkatëse të vizave përcaktohen në aneksin nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi. Përjashtimi nga tarifa e vizës, përveç kur përcaktohet ndryshe, mund të bëhet për arsye të justifikuara shtetërore, me kërkesë të autoritetit të institucionit shtetëror dhe me miratimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe të ambasadorëve të Republikës së Shqipërisë, në përfaqësitë diplomatike jashtë shtetit. Tarifat e vizave për të miturit nga mosha 6-12 vjeç janë sa gjysma e tarifave të vizave për të rriturit.

4. Tarifa për vizat nuk zbatohet për:

a) fëmijët deri në moshën 6 vjeç;

b) mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit;

c) anëtarët e organizatave jofitimprurëse të moshës nën 25 vjeç, të cilët marrin pjesë në seminare, konferenca, ngjarje sportive, kulturore apo arsimore, të organizuara nga organizatat jofitimprurëse;

ç) nxënësit e shkollave, studentët, studentët pasuniversitarë dhe mësuesit shoqërues që synojnë të qëndrojnë për qëllime të studimit ose trajnimit arsimor;

d) studiues, të cilët udhëtojnë për qëllime të kryerjes së kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë;

dh) rastet humanitare;

e) të huajt e angazhuar në promovimin e interesave kulturore apo sportive, si dhe interesat në fushën e politikës së jashtme, politikës së zhvillimit dhe fusha të tjera me interes të lartë publik.

5. Aplikimi për vizë jashtë listës së shteteve të përcaktuara në anekset bashkëlidhur bëhet vetëm me miratim të autoritetit përgjegjës në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

6. Përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë për të hyrë dhe qëndruar në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë për 180 ditë, për qëllime të barasvlershme me ato të vizës së tipit "C", të parashikuara në ligjin nr. l08/2013 "Për të huajt", shtetasit e shteteve, që:

a) janë të pajisur me një vizë të vlefshme Shengen me shumë hyrje-dalje, me kushtin që kjo vizë të jetë përdorur më parë në njërin nga shtetet e zonës Shengen apo personat të jenë pajisur me leje të vlefshme qëndrimi në njërin nga shtetet e zonës Shengen;

b) janë të pajisur me vizë të vlefshme me shumë hyrje-dalje apo leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe e Irlanda e Veriut, me kushtin që vizat të jenë përdorur më parë në këto shtete;

c) hyjnë dhe qëndrojnë në shtetet e zonës Shengen pa vizë.

7. Gjatë aplikimit për vizë mund të përjashtohen nga detyrimi për t'u paraqitur personalisht pranë përfaqësive të shtetit shqiptar kategoritë e mëposhtme:

a) Të huajt, të cilët janë të pajisur me pasaportë diplomatike;

b) Rastet për arsye humanitare;

c) Personalitetet e larta shtetërore, bashkëshortët e tyre shoqërues, si dhe delegacionet që i shoqërojnë në vizitat për qëllime zyrtare;

ç) I huaji me titull mbretëror dhe anëtarë të tjerë të lartë të familjes së tij mbretërore, kur janë të ftuar në vizitat për qëllime zyrtare;

d) Të huajt e organizuar në grupe turistike, të ftuar nga një shoqëri turistike shqiptare, të cilët aplikojnë në njërën nga përfaqësitë konsullore, në shtetet fqinje ose në vende të tjera, të ndryshme nga ato të origjinës;

dh) Të huajt, të cilët kanë aplikuar më parë vetë për vizë, brenda një afati prej 59 (pesëdhjetë e

nëntë) muajsh.

B. Dokumentacioni bazë i nevojshëm për të gjitha kategoritë për t'u pajisur me vizë pranë zyrave konsullore të përfaqësive të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, aplikuesi për vizë duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin e aplikimit për vizë, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 5, bashkëlidhur këtij vendimi, të plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi, i cili shpërndahet pa pagesë.

2. Fotografinë e aplikuesit, e cila duhet të jetë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, e marrë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm.

3. Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, si dhe fotokopje të faqeve me shënime me interes për udhëtimin.

Dokumenti i udhëtimit sipas parashikimit në ligjin nr. 108/2013 "Për të huajt", duhet të jetë me vlefshmëri së paku 3 (tre) muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar dhe të ketë së paku 2 (dy) faqe bosh, në të cilat mund të lëshohet një vizë. Për raste të vlerësuara si të domosdoshme, mund të pranohet dokument udhëtimi, ndryshe nga sa përcaktohet në këtë pikë, me kusht që afati i vizës së kërkuar të mos kalojë afatin e vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit.

4. Policen e Sigurimit Shëndetësor në udhëtim, e cila mbulon kohëzgjatjen e vizës.

Polica e sigurimit duhet të sigurojë aplikuesin në rast sëmundjesh të papritura apo aksidenti dhe duhet të përfshijë transportin e kthimit në rast vdekjeje, në një vlerë minimale 30 000 (tridhjetë mijë) euro.

Mbajtësit e pasaportave diplomatike përjashtohen nga kërkesa për të paraqitur policen e sigurimit shëndetësor të udhëtimit. Bëjnë përjashtim nga paraqitja e polices së sigurimit shëndetësor të udhëtimit grupe të caktuara profesionale, të cilat janë të mbuluara tashmë nga sigurimi shëndetësor i udhëtimit si rezultat i aktiviteteve të tyre profesionale.

5. Deklaratën, ku të shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestarit ligjor sipas legjislacionit në fuqi për udhëtimin e të miturit. Në rast të udhëtimit të një të mituri të pashoqëruar apo të shoqëruar nga njëri prind, duhet të paraqitet një deklarim, me anë të cilit prindi/prindërit ose kujdestari ligjor jep/japin pëlqimin e tij/tyre për hyrjen ose daljen e të miturit nga territori i Republikës së Shqipërisë.

6. Ftesën e nënshkruar nga ana e ftuesit.

Ftesës i bashkëlidhet një fotokopje e dokumentit të identifikimit të ftuesit. Në rastin kur ftesa është bërë nga një i huaj me qëndrim në Republikën e Shqipërisë, ftesës i bashkëlidhet dhe fotokopja e lejes së tij të qëndrimit.

C. Dokumentacioni shtesë që kërkohet sipas llojit të vizës, përveç dokumentacionit të përgjithshëm, në varësi të tipit të vizës së kërkuar, i huaji duhet të paraqesë edhe dokumentacionin shoqërues, si më poshtë vijon:

1. Për vizë të tipit A:

a) fotokopjen e vizës së vendit të destinacionit, nëse është e nevojshme pajisja me vizë për hyrjen në atë vend;

b) kartelën e vaksinimit, kur i huaji vjen nga vende të prekura nga epidemi apo sëmundje.

2. Për vizë të tipit C - turizëm:

a) dokumentin e rezervimit vajtje-ardhje të biletës ose të vërtetojë mundësinë e transportit personal;

b) dokumentet në lidhje me strehimin gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë;

c) dokumente që tregojnë se kërkuesi posedon mjete të mjaftueshme financiare për jetesë, si për kohëzgjatjen e qëndrimit dhe për kthimin në vendin e tij të origjinës apo të banimit ose kur qëndron transit në një vend të tretë, në të cilin ai është i sigurt për të hyrë ose që është në gjendje të gëzojë mjete të tilla financiare, të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

3. Për vizë të tipit C - turizëm, të organizuar në grupe turistike, të ftuara nga një shoqëri turistike shqiptare:

a) fotokopjen e fletës së pasaportës që tregon hyrjen dhe qëndrimin e ligjshëm të shtetasit të huaj

në vendin ku ndodhet në çastin e aplikimit për vizë;

b) fotokopjen e noterizuar të licencës së shoqërisë turistike shqiptare, e cila fton grupin turistik të huaj për turizëm.

4. Për vizë të tipit C - për motive shkencore, kulturore, sportive dhe humanitare:

a) ftesën nga subjekti shkencor, kulturor, sportiv apo humanitar vendas, për pjesëmarrjen e të huajit në veprimtarinë për të cilin kërkohet lëshimi i vizës përkatëse;

b) rezervimin e hotelit apo deklaratën e mikpritjes;

c) dokumente që tregojnë se kërkuesi posedon mjete të mjaftueshme financiare për jetesë, si për kohëzgjatjen e qëndrimit dhe për kthimin në vendin e tij të origjinës apo të banimit ose për kohën kur qëndron transit në një vend të tretë, në të cilin ai është i sigurt për të hyrë ose që është në një pozicion të përfitimit të mjeteve të tilla financiare, të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi;

ç) dokumentin që vërteton ekzistencën e një marrëdhënieje shkencore, kulturore, sportive apo humanitare të qëndrueshme në vendin e origjinës të kërkuesit të vizës.

5. Për vizë të tipit C - për motive zyrtare:

a) ftesën nga institucioni pritës;

b) notën verbale nga institucioni, ku i huaji është i punësuar.

6. Për vizë të tipit C - për motive mjekësore:

a) ftesën nga institucioni pritës;

b) epikrizën, origjinalin apo fotokopjen, kryesisht për diagnozën e lëshuar nga mjeku vendas;

c) deklaratën e institucionit spitalor në Republikën e Shqipërisë, publik apo privat, të licencuar, ku të përcaktohen: lloji i trajtimit mjekësor, data e fillimit dhe përafërsisht kohëzgjatja e trajtimit mjekësor, kostoja e përafërt e trajtimit, si dhe subjekti, që do t'i mbulojë këto kosto;

ç) dokumentet që dëshmojnë ekzistencën e burimeve të nevojshme e të mjaftueshme për të mbuluar pjesën e shpenzimeve shëndetësore, si dhe ato të qëndrimit jashtë strukturës shëndetësore apo të kthimit në atdhe të personit që kurohet e të shoqëruesit të tij;

d) sigurimin shëndetësor në udhëtim të shoqëruesit/shoqëruesve të të sëmurit për të përballuar shpenzimet e nevojshme në rast shtrimi të menjëhershëm, për qëndrimin e tij në Shqipëri, si dhe shpenzimet e kthimit në atdhe.

7. Për vizë të tipit C - për motive profesionale, tregtare dhe biznesi:

a) ftesën nga subjekti pritës;

b) dokumentin, që provon veprimtarinë profesionale, tregtare në vendin përkatës, me të cilin lidhen motivet e vizitës;

c) në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit;

ç) fotokopjen e certifikatës së regjistrimit në punë sipas nenit 73 të ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", në varësi të qëllimit të pajisjes me vizë.

7.1 Për drejtuesit e automjeteve do të kërkohen edhe:

i) licenca e transportit ndërkombëtar të automjetit (kamionit);

ii) leja e qarkullimit ndërkombëtar;

iii) dëshmia ndërkombëtare e aftësisë së drejtuesit të automjetit.

8. Për vizë të tipit D/AE/AP/AT/APU:

a) ftesën nga subjekti pritës, së bashku me fotokopjen e dokumentit të tij të identifikimit;

b) dokumentin që provon veprimtarinë apo aftësinë profesionale, tregtare në vendin e aplikuesit, me të cilin lidhen motivet e kërkesës së vizës së aplikuesit;

c) në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit ftues;

ç) fotokopjen e lejes së punës, të lëshuar nga autoriteti përkatës shqiptar.

9. Për vizë të tipit D/ST:

a) dokumentin, që vërteton pranimin në një institucion arsimor shqiptar;

b) garancinë pasurore, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit;

c) dokumentin e sigurimit shëndetësor, që përkon me kohëzgjatjen e qëndrimit në territor;

ç) dokumentin që vërteton strehimin në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) dokumentin, që provon njohjen e gjuhës, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë studimet. Prova e njohjes së gjuhës mund të verifikohet edhe me intervistë nga personeli i përfaqësisë.

10. Për vizë të tipit D/BF:

a) fotokopjen e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar ose fotokopjen e dokumentit të identifikimit të të huajit, si dhe të lejes së tij të qëndrimit, të cilët kërkojnë bashkimin familjar me kërkuesin;

b) certifikatën e lëshuar jo më shumë se një muaj para aplikimit për vizë nga autoritetet përkatëse në vendin e origjinës, e cila vërteton lidhjen e personit, që kërkon bashkim familjar në Shqipëri;

c) dokumente të tjera shtesë, si fotografi, filmime etj., që provojnë lidhjen e qëndrueshme me personin, që kërkon bashkim familjar në rast se kërkohet;

ç) dokumente, që vërtetojnë se pritësi i huaj ka banesë të përshtatshme në Shqipëri dhe plotëson kushtet për banim (fotokopje të noterizuar të kontratës së qirasë apo të një dokumenti që tregon se ka në pronësi një banesë etj.);

d) fotokopje të noterizuar të dokumentit që vërteton se i huaji pritës është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka sasi të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar jetën e personit/personave që do të vijnë në Republikën e Shqipërisë.

11. Për vizë të tipit D/VHF:

a) fotokopjen e noterizuar të licencës së ushtrimit të veprimtarive humanitare;

b) fotokopjen e lejes së punës ose të certifikatës së regjistrimit në punë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;

c) deklaratën për motivin e hyrjes nga subjekti i bashkësisë fetare që ka lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave sipas pikës 5 të nenit 10 të Kushtetutës.

12. Për vizë të tipit D/DS:

a) notën verbale nga institucioni, ku është punësuar i huaji që aplikon për vizë;

b) ftesën nga institucioni pritës, kur është e nevojshme.

13. Për vizë të tipit D/PS:

a) ftesën nga subjekti pritës;

b) fotokopjen e noterizuar të kontratës së punës me pritësin në Shqipëri;

c) fotokopjen e lejes së punës, të lëshuar nga autoriteti përkatës shqiptar;

ç) dokumentin, i cili provon regjistrimin e të huajit, që kërkon vizë në institucionet përgjegjëse të punësimit në vendin e origjinës, të njohura sipas marrëveshjeve për punësim sezonal.

14. Për vizë të tipit D/H, dokumente që provojnë motivet humanitare, për të cilat kërkohet viza.

III. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LEJE QËNDRIMI

A. Kritere të përgjithshme dhe procedurat për t’u pajisur me leje qëndrimi

1. Kërkesa për lëshimin e lejes së qëndrimit ose për ripërtëritjen e saj depozitohet personalisht ose përmes sistemit elektronik të sigurt *on-line*, ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të caktuar sipas ligjit pranë autoriteteve rajonale përgjegjëse për kufirin dhe migracionin. Aplikimi për leje qëndrimi nëpërmjet sistemit elektronik të sigurt *on-line* parashikohet për shtetasit e shteteve të përcaktuara në listën e dhënë në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Kushtet për krijimin dhe funksionimin e këtij sistemi parashikohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

2. I huaji pajiset me leje qëndrimi sipas formës dhe përmbajtjes të përcaktuara në modelet e dhëna në aneksin nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi, deri në prodhimin dhe vënien në funksionim të formatit të lejes së qëndrimit në formën e dokumentit biometrik. I huaji paraqitet personalisht për aplikimin e dokumentit biometrik të lejes së qëndrimit.

3. Vlera e tarifës së shërbimit të lejes së qëndrimit për të huajt përcaktohet në aneksin nr. 7, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Për të huajt, që punojnë në organizata dhe shoqata jofitimprurëse, bamirëse, humanitare, fondacione dhe shoqata fetare, në bazë të parashikimeve në marrëveshje ndërkombëtare me shtetin shqiptar për përjashtim nga taksat, si dhe për kategoritë e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas.

Për kategoritë e përcaktuara në nenet 53, pika 1, shkronja “a”, e 58 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, vlera e tarifës së lejes së qëndrimit mbulohet nga buxheti i autoritetit për azilin dhe refugjatët.

5. Dokumentacioni nga vendi i origjinës dhe/ose nga vendi ku i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe e i lëshuar në 6-mujorin e fundit, i vërtetuar dhe i legalizuar në bazë të detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Dokumentet e depozituara në momentin e aplikimit për leje qëndrimi pranë autoritetit rajonal për kufirin dhe migracionin që shqyrton aplikimin duhet të konfirmohen zyrtarisht nga autoritetet përkatëse.

6. Kostoja e jetesës për të huajin, që përcaktohet në pikën 5 të nenit 42 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, duhet të përkojë, të paktën, me standardin minimal të jetesës, të indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura, të parashikuar në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

B. Dokumentacioni bazë dhe i nevojshëm për të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit

Për t’u pajisur me leje qëndrimi, i huaji depoziton këto dokumente:

1. Formularin e aplikimit për leje qëndrimi përkatësisht të plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi, sipas modeleve të përcaktuara në aneksin nr. 8, bashkëlidhur këtij vendimi, i cili shpërndahet pa pagesë.

2. Dy fotografi të aplikuesit, të bëra jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm dhe qartë.

Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

3. Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me të cilin i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe fotokopjen e faqeve me shënime me interes për udhëtimin, si dhe gjeneralitetet e mbajtësit, viza e tipit D, vulat në hyrje-dalje etj.

Dokumenti i udhëtimit, sipas parashikimit në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, duhet të ketë vlefshmëri së paku 3 (tre) muaj më shumë se afati i lejes së qëndrimit të kërkuar.

4. Dokumentet që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri.

Kontratën e blerjes ose të marrjes me qira të banesës në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri ose çdo dokument tjetër që provon strehimin e garantuar në Republikën e Shqipërisë.

5. Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.

6. Dëshminë e sigurimit shëndetësor për në Shqipëri.

C. Dokumentacioni i veçantë sipas llojit të lejes së qëndrimit

1. Dokumentet shtesë për lejen e qëndrimit për të punësuar, tipi “B”, janë si më poshtë vijon:

a) Fotokopja e lejes së punës ose certifikatës së regjistrimit në punë.

b) Vërtetimi për deklarimin e punësimit në zyrën përkatëse të punësimit, për të huajt, që, në bazë të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, janë të përjashtuar nga ky detyrim.

c) Fotokopja e kontratës së punës.

2. Dokumentet shtesë për lejen e qëndrimit për të vetëpunësuarit, tipi “B”, janë si më poshtë vijon:

a) Fotokopja e lejes së punës ose certifikatës së regjistrimit në punë.

b) Vërtetimi për deklarimin e punësimit në zyrën përkatëse të punësimit, për të huajt, që, në bazë të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, janë të përjashtuar nga ky detyrim.

c) Vërtetimi i regjistrimit në degën e tatim-taksave ku do të kryejnë aktivitetin.

3. Dokumentet shtesë për lejen e qëndrimit “Kartë blu AL”, janë si më poshtë vijon:

a) Fotokopja e lejes së punës për punonjës me kualifikim të lartë, në përputhje me nenin 98 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”.

b) Kontrata e punës, ku vërtetohet se paga mujore të jetë sa 150% e pagës mesatare të caktuar në Shqipëri.

4. Dokumentet shtesë për lejet e qëndrimit për raste të veçanta, përkatësisht të tipit “B” dhe “S”, janë si më poshtë vijon:

a) Për punësim stinor, të trajnuar pa pagesë, shkëmbime rinore, shërbime vullnetare paraqiten:

i) fotokopja e lejes së punës, në përputhje me nenet 92, 93 e 95 të ligjit nr. 108/2013 “Për të

huajt”;

ii) fotokopja e marrëveshjes së nënshkruar me subjektin që ndodhet në Shqipëri;

iii) dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për jetesën gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar.

b) Për kërkim shkencor paraqiten:

i) certifikata e regjistrimit në punë në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;

ii) fotokopja e marrëveshjes së nënshkruar me organizatën kërkimore-shkencore apo institucionin e edukimit të lartë në Shqipëri;

iii) dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar.

c) Për studentë dhe nxënës shkolle paraqiten:

i) dokumenti i pranimit nga një institucion arsimor në Shqipëri;

ii) dëshmia e burimeve të mjaftueshme financiare për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar;

iii) dëshmia e njohjes së gjuhës.

ç) Për të punësuar pranë institucioneve shtetërore humanitare, fetare apo organizatave jofitimprurëse paraqiten:

i) certifikata e regjistrimit në punë në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;

ii) vërtetimi i institucionit qendror, ku i huaji është punësuar ose kontraktuar.

d) Për të punësuar pranë institucioneve humanitare, fetare apo organizatave jofitimprurëse, të njohura e të regjistruara, në organet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë paraqiten:

i) fotokopja e certifikatës së regjistrimit në punë në përputhje me shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 73 të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”;

ii) fotokopja e aktit të regjistrimit të organizatës jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;

iii) konfirmimi i titullarit të institucionit, ku shprehet marrëdhënia e të huajit me këtë institucion.

5. Dokumentet shtesë për leje qëndrimi të tipit “B”, për banorët afatgjatë të një shteti tjetër janë, si më poshtë vijon:

a) fotokopja e lejes së punës ose e certifikatës së regjistrimit në punë, si dhe për të vetëpunësuarit, vërtetimi i regjistrimit në degën e tatim-taksave ku do të kryejnë aktivitetin. Për të huajt, që, në bazë të ligjit, janë të përjashtuar nga ky detyrim, kërkohet vërtetim për deklarimin e punësimit në zyrën përkatëse të punësimit;

b) fotokopja e lejes së qëndrimit të banorit afatgjatë të shtetit tjetër.

6. Dokumentet për leje qëndrimi për motive të tjera, të tipit “B”, janë si më poshtë vijon:

a) certifikata e pronësisë së banesës (fotokopje e noterizuar e kontratës së shitblerjes);

b) dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, sipas motivit të qëndrimit, për periudhën e kërkuar të qëndrimit;

c) deklarata individuale mbi motivin e qëndrimit në Shqipëri.

7. Dokumentet shtesë për leje të përkohshme qëndrimi për bashkim familjar, të tipit “B”, janë si më poshtë vijon:

a) Fotokopja e lejes së qëndrimit të familjarit ftues (në rastin kur ftuesi është shtetas i huaj);

b) fotokopja e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar (në rastin kur ftuesi është shtetas shqiptar);

c) certifikata familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

ç) dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme të ftuesit të huaj për përballimin e jetesës brenda standardeve në Shqipëri;

d) deklarata noteriale e bashkëjetuesit (në rastin e bashkëjetesës);

dh) dokumenti ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër kur kërkohet bashkimi familjar vetëm i të miturit/miturve.

8. Dokumenti për trajtimin me leje qëndrimi për raste humanitare, tipi “A”, është fotokopja e dokumentit të udhëtimit (nëse i huaji e ka).

Ç. Dokumentacioni për ripërtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit e tipit “B”

I huaji për përtëritjen e lejes së përkohshme të qëndrimit, duhet të plotësojë kërkesat e nenit 38 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, dhe dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje të përkohshme qëndrimi, përjashtuar certifikatën e gjendjes gjyqësore. I huaji duhet të paraqesë, gjithashtu, dëshminë e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe ato të taksave lokale për vitin e fundit kalendarik, sipas specifikave të motivit të lejes së qëndrimit.

D. Dokumentacioni për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit të tipit “C”

Për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit, i huaji duhet të plotësojë kërkesat e nenit 61 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, dhe përveç plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me leje të përkohshme qëndrimi, në varësi të motivit, i huaji duhet të paraqesë vërtetim plotësues mbi njohuri për gjuhën shqipe, si dhe vërtetim të gjendjes gjyqësore të marrë në Shqipëri, të lëshuar në 6-mujorin e fundit.

DH. Dokumentacioni për lëshimin e lejes së qëndrimit për raste të veçanta të tipit “C”

1. Kriteret dhe procedura për lëshimin e lejes së përhershme të qëndrimit të tipit “C” janë ato të parashikuara në kreun III të këtij vendimi.

2. I huaji pajiset me leje të përhershme qëndrimi në raste të veçanta, në përmbushje të kushteve të parashikuara në nenin 65 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, nëse:

a) sipas pikës 1 të nenit 65, ai paraqet dokumentacionin bazë dhe certifikatën që vërteton lidhjet familjare me shtetasin shqiptar apo certifikatën që vërteton vendin e lindjes, si dhe kopje të lejes së përhershme të qëndrimit të prindërve;

b) sipas pikës 2 të nenit 65 të ligjit nr. 108/2013, i huaji investues, përveç dokumentacionit bazë për pajisjen me leje qëndrimi, duhet të vërtetojë kryerjen e investimit në Shqipëri me një vlerë jo më pak se 1 (një) milion euro, si dhe të depozitojë kontratat e punësimit me afat punësimi së paku njëvjeçar, për të paktën 10 (dhjetë) shtetas shqiptarë, ku të vërtetohet derdhja e sigurimeve shoqërore.

Në rastin e familjarëve apo të personelit kyç, të huajit investues, kur nuk është paraqitur më parë dokumentacioni i nevojshëm, duhet të depozitohen edhe certifikatat që provojnë, përkatësisht, lidhjet familjare apo vërtetimet mbi cilësinë e personelit kyç të të huajit investues.

E. Dispozita të veçanta për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

1. Shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët qëndrojnë pa leje qëndrimi për 1 (një) vit në Republikën e Shqipërisë, mund të rihyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë pa pasur nevojë për leje qëndrimi, nëse kanë qëndruar më shumë se 3 (tre) muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose gjatë periudhës së qëndrimit njëvjeçar a pas qëndrimit një vit ose këto periudha të llogaritura së bashku.

2. Për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, afati i lëshimit të lejes së qëndrimit për herë të parë, si dhe afati i përtëritjes së saj lidhet me motivin e kërkuar dhe provohet me anë të dokumentacionit të përcaktuar në këtë vendim.

3. Shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nëse përmbushin kriteret, mund të aplikojnë për leje qëndrimi të përhershme, pas qëndrimit për 5 (pesë) vjet në Republikën e Shqipërisë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Deri në miratimin, prodhimin dhe vënien në qarkullim të modeleve të reja të dokumenteve për të huajt, të vizës pullë dhe lejes së qëndrimit, do të përdoren dokumente, viza pullë dhe modelet e parashikuara në vendimin nr. 362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave.

2. Masat administrative, të parashikuara në nenin 104 të ligjit nr. 108/2013, datë 28.3.2013 “Për të huajt”, vendosen nga autoriteti shtetëror përgjegjës, në nivel rajonal/vendor, sipas formatit të dhënë në aneksin nr. 9, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 362, datë 1.4.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e

këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR. 1

Tabela 1

Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve përjashtohen nga detyrimi i regjistrimit pranë autoritetit rajonal për kufirin dhe migracionin

Nr.	**Shteti**
1	Australi
2	Andorra
3	BE/zona Shengen
4	Izrael
5	Japoni
6	Kanada
7	Lihtenshtejn
8	San Marino
9	Selia e Shenjtë
10	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
11	Zelandë e Re

Tabela 2

Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve mund të aplikojnë përmes sistemit elektronik on-line të sigurt

Nr.	**Shteti**
1	Australi
2	Andorra
3	BE/zona Shengen
4	Izrael
5	Japoni
6	Kanada
7	Lihtenshtejn
8	San Marino
9	Selia e Shenjtë
10	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
11	Zelandë e Re

ANEKSI NR. 2

Listave e shteteve, shtetasit e huaj mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit që hyjnë pa vizë në Shqipëri

	Lista e shteteve që hyjnë në Shqipëri pa vizë duke përdorur pasaportë diplomatike ose shërbimi	**Diplomatike**	**Shërbimi**
1	Afrika e Jugut	x	x
2	Algjeri	x	x
3	Egjipt	x	x
4	Kinë	x	x
5	Rusi	x	x
6	Moldavi	x	x
7	Uruguai	x	x
8	Kosta Rika	x	x
9	Vietnam	x	x

ANEKSI NR. 3

Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe dokumenti që duhet të paraqesin

Nr.	**Shteti**	**Me pasaportë**	**Me kartë identiteti**
1	Andorra	x	
2	Argjentinë	x	
3	Armeni*	x	
4	Australi	x	x
5	Austri	x	x
6	Azerbajxhan*	x	
7	Belgjikë	x	x
8	Bosnjë dhe Hercegovinë	x	
9	Brazil	x	
10	Britani e Madhe	x	x
11	Bullgari	x	x
12	Danimarkë	x	x

13	Estoni	x	x
14	Finlandë	x	x
15	Francë	x	x
16	Gjermani	x	x
17	Greqi	x	x
18	Holandë	x	x
19	Hong Kong, Kinë*	x	x
20	Hungari	x	x
21	Irlandë	x	x
22	Islandë	x	x
23	Itali	x	x
24	Izraeli	x	
25	Japoni	x	
26	Kanada	x	x
27	Kazakistan*	x	x
28	Kili	x	
29	Kosovë	x	x
30	Kroaci	x	
31	Letoni	x	x
32	Lihtenshtejn	x	x
33	Lituani	x	x
34	Luksemburg	x	x
35	Malajzi	x	
36	Mali i Zi	x	x
37	Maltë	x	x
38	Maqedoni	x	x
39	Monako	x	x
40	Norvegji	x	x
41	Poloni	x	x
42	Portugali	x	x
43	Qipro	x	x
44	Rep. e Koresë (Jugu)	x	x
45	Republika Çeke	x	x
46	Rumani	x	x
47	San Marino	x	x
48	Selia e Shenjtë	x	x
49	Serbia	x	
50	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	x	x
51	Singapor	x	x
52	Sllovaki	x	x
53	Slloveni	x	x
54	Spanjë	x	x
55	Suedi	x	x
56	Tajvan, Kinë*	x	
57	Turqi*	x	
58	Ukrainë*	x	

59	Zelandë e Re	x	x
60	Zvicër	x	x

Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë si rrjedhojë e hyrjes pa vizë në zonën Shengen

1	Antigua dhe Barbuda*	x
2	Bahamas*	x
3	Barbado*	x
4	Brunei*	x
5	Guatemalë*	x
6	Honduras*	x
7	Kosta Rika*	x
8	Macau, Kinë*	x
9	Mauritius*	x
10	Meksikë*	x
11	Nikaragua*	x
12	Panama*	x
13	Paraguai*	x
14	Salvador*	x
15	Seychelles*	x
16	St. Kitts and Nevis*	x
17	Uruguai*	x
18	Venezuelë*	x

* Shtetasit e shteteve të shënuara me simbolin (*), për të qëndruar më shumë se 90 ditë në 180 ditë duhet të pajisen me vizë të tipit “D”, me qëllim aplikimin për leje qëndrimi.

ANEKSI 4

Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi,si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë

	SHTETET QË HYJNË ME VIZË		VIZA "C"			VIZA "D""
Nr.	**Shteti**	**Përfaqësia ku mund të aplikohet**	**Kosto 1-hyrje**	**Kosto 2-hyrje**	**Kosto shumë hyrje**	**Kosto**
1.	Afganistan	Ankara, Stamboll	€ 45,00	€ 45,00	€ 45,00	€ 45,00
2.	Afrika e Jugut	Romë, Londër	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
3.	Algjeria	Paris	gratis	gratis	gratis	gratis
4.	Angola	Romë	€ 50,00	€ 75,00	€ 100,00	€ 100,00
5.	Antigua dhe Barbuda	Londër	-----	-----	-----	€ 35,00
6.	Arabi Saudite	Riad	€ 54,00	€ 54,00	€ 54,00	€ 54,00
7.	Armenia	Ankara, Moskë	-----	-----	-----	€ 40,00
8.	Azerbajxhan	Ankara, Moskë	-----	-----	-----	€ 40,00
9.	Bahamas	Londër	-----	-----	-----	€ 35,00
10.	Bahrein	Riad, Doha	€ 60,00	€ 60,00	€ 60,00	€ 60,00
11.	Bangladesh	Kuala Lumpur	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
12.	Barbados	Londër	-----	-----	-----	€ 25,00
13.	Belize	Londër	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
14.	Benin	Paris	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
15.	Bjellorusi	Moskë, Varshavë	€ 50,00	€ 70,00	€ 100,00	€ 100,00
16.	Bolivi	Brazilia	€ 30,00	€ 30,00	€ 50,00	€ 50,00
17.	Botsvanë	Paris	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
18.	Bregu i Fildishtë	Londër	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
19.	Brunei	Romë, Riad	-----	-----	-----	€ 25,00
20.	Burkina Faso	Romë	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
21.	Egjipt	Kajro	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
22.	Ekuador	Brazilia	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00
23.	Emiratet e Bashkuara Arabe	Abu Dhabi	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
24.	Eritre	Kajro	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
25.	Etiopi	Kajro	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
26.	Filipine	Kuala Lumpur	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
27.	Gabon	Kajro, Romë	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
28.	Gana	Kajro, Romë	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
29.	Gjeorgji	Ankara, Stamboll	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
30.	Gjibraltar	Madrid	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
31.	Guajanë	Brazilia, Romë	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00

32.	Guatemalë	Brazilia	-----	------	-----	€ 25,00
33.	Guineja	Kajro, Stamboll	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
34.	Haiti	Brazilia, Nju-Jork	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
35.	Honduras	Brazilia, Nju-Jork	-----	-----	-----	€ 30,00
36.	Hong Kong, Kinë	Pekin	-----	-----	-----	€ 35,00
37.	Indi	Nju-Deli	€ 15,00	€ 15,00	€ 15,00	€ 15,00
38.	Indonezi	Kuala Lumpur	€ 33,00	€ 33,00	€ 33,00	€ 33,00
39.	Irak	Ankara, Stamboll	€ 71,00	€ 71,00	€ 71,00	€ 71,00
40.	Iran	Ankara, Stamboll	gratis	gratis	gratis	gratis
41.	Ishujt Fixhi	Londër, Tokio	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
42.	Jemen	Riad, Abu Dhabi	€ 20,00	€ 70,00	€ 70,00	€ 70,00
43.	Jordani	Kajro	€ 23,00	€ 23,00	€ 23,00	€ 23,00
44.	Kamboxhia	Kuala Lumpur, Pekin	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
45.	Kamerun	Kajro	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
46.	Katar	Doha	€ 20,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
47.	Kazakistan	Ankara, Moskë	------	------	------	€ 100,00
48.	Kenia	Kajro	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
49.	Kinë, Republika Popullore	Pekin	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00	10,00
50.	Kirgistan	Ankara, Moskë	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
51.	Kolumbi	Brazilia	€ 45,00	€ 45,00	€ 45,00	€ 45,00
52.	Kongo	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
53.	Kore, Republika Popullore	Pekin, Sofje	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00
54.	Kosta Rika	Brazilia	-----	-----	-----	€ 30,00
55.	Kubë	Brazilia, Sofje	€ 30,00	€ 30,00	€ 65,00	€ 65,00
56.	Kuvajt	Kuvajt	€ 50,00	€ 100,00	€ 100,00	€ 100,00
57.	Lesoto	Kajro, Stamboll	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
58.	Libani	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 50,00	€ 50,00
59.	Liberi	Bukuresht	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
60.	Libi	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
61.	Madagaskar	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
62.	Makao	Pekin	-----	-----	-----	€ 35,00
63.	Malavi	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
64.	Maldives	Londër	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
65.	Mali	Romë	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
66.	Marok	Bukuresht, Paris	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00
67.	Mauritani	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
68.	Mauritius	Londër	-----	-----	-----	€ 25,00
69.	Meksikë	Romë	-----	-----	-----	€ 30,00
70.	Moldavi	Bukuresht, Sofje, Ankara, Stamboll	€ 50,00	€ 75,00	€ 100,00	€ 100,00
71.	Mongoli	Moskë, Pekin	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
72.	Mozambik	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
73.	Namibi	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
74.	Nepal	Nju-Delhi, Kuala Lumpur	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00

75.	Nigeri	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
76.	Nikaragua	Romë	-----	-----	-----	€ 30,00
77.	Oman	Riad, Abu Dhabi	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00	€ 30,00
78.	Pakistan	Kajro, Stamboll	€ 20,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
79.	Palestinë	Kajro, Stamboll	gratis	gratis	gratis	gratis
80.	Panama	Romë	-----	------	-----	€ 100,00
81.	Paraguai	Brazilia	-----	-----	-----	€ 50,00
82.	Peru	Brazilia, Madrid	€ 25,00	€ 60,00	€ 60,00	€ 60,00
83.	Republika Dominikane	Brazilia, Nju-Jork	€ 40,00	€ 50,00	€ 70,00	€ 70,00
84.	Ruandë	Kajro, Stamboll	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
85.	Rusi	Moskë	€ 30,00	€ 50,00	€ 50,00	€ 50,00
86.	Salvador	Londër	-----	------	-----	€ 20,00
87.	Sao Tome Principe	Londër	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
88.	Senegal	Kajro, Stamboll, Paris	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
89.	Seychelles	Kajro	---	---	---	€ 35,00
90.	Sierra Leone	Kajro, Londër	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00	€ 35,00
91.	Siri	Kajro, Stamboll	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
92.	Somali	Kajro, Riad	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
93.	Sri Lanka	Kuala Lumpur, Nju-Delhi	€ 6,00	€ 10,00	€ 10,00	€ 10,00
94.	Sudan	Kajro	€ 62,00	€ 62,00	€ 62,00	€ 62,00
95.	Suriname	Brazilia	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
96.	St.Kitts and Nevis	Tokio, Londër	-------	-------	-----	€ 35,00
97.	Tailandë	Kuala Lumpur	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
98.	Tanzani	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
99.	Taxhikistan	Ankara, Moskë	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
100.	Togo	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
101.	Trinidad Tabako	Londër	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00	€ 20,00
102.	Tunizi	Kajro, Stamboll	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00	€ 11,00
103.	Turkmenistan	Ankara, Stamboll, Moskë	€ 30,00	€ 50,00	€ 60,00	€ 60,00
104.	Turqi	Ankara, Stamboll	------	------	------	€ 35,00
105.	Ugandë	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00	€ 25,00
106.	Uruguai	Brazilia, Romë	-----	-----	------	€ 30,00
107.	Uzbekistan	Stamboll, Moskë	€ 30,00	€ 50,00	€ 100,00	€ 100,00
108.	Venezuelë	Brazilia, Romë	------	------	------	€ 30,00
109.	Vietnam	Kuala Lumpur, Pekin	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
110.	Xhamajkë	Londër, Nju-Jork	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00	€ 40,00
111.	Zambia	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
112.	Zimbabve	Kajro, Stamboll	€ 25,00	€ 40,00	€ 80,00	€ 80,00
113.	Të tjera	Në Amb. RSH më të afërt.	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00	Reciprocitet. Në mungesë € 35,00

Photo

Formulari i aplikimit për vizë Shqiptare
Application for Albanian Visa

EMBASSY OF ALBANIA

Ky formular është pa pagesë

This application form is free

1. Surname(s) (family name(s))/ Mbiemri (at)		Vetëm për Konsullin
2. Surname(s) at birth (earlier family name(s))/ Mbiemri i lindjes (mbiemra më të hershëm)		**Data e aplikimit:**
3. First names (given names)/ Emri (at)		
4. Date of birth (year-month-day)/ Datëlindja (viti-muaji-dita)	**5. ID-number (optional)/ Numri i identifikimit (jo i detyrueshëm)**	**Emri i Konsullit që pranon aplikimin:**
6. Place and country of birth/ Rrethi dhe vendi i lindjes		
7. Current nationality/ies/ Shtetësi(të) aktuale	**8. Original nationality (nationality at birth)/ Shtetësia origjinale (Shtetësia e lindjes)**	Dokumentat mbështetës: 1.Vlefshmëria e pasap. 2.Mjete Financiare 3.Transporti 4.Sigurimi Shendetsor Të tjera
9. Sex Gjinia (Mashkullore / Femërore) ☐ Male ☐ Female	**10. Marital status : Gjëndja Civile** ☐ Single/ beqar(e) ☐ Married/ i(e) martuar ☐ Separated / i(e) ndarë ☐ Divorced/ i(e) divorcuar ☐ Widow(er) / i(e) ve ☐ Other/ tjetër	
11. Father's name/ Emri i babait	**12. Mother's name/ Emri i nënës**	

13. Type of passport:/ Tipi i Pasaportës ☐ National passport/ Pasaportë kombëtare ☐ Diplomatic passport/ Pasaportë diplomatike ☐ Service passport/ Pasaportë shërbimi ☐ Travel document (1951 Convention) / Dokument udhëtimi (Konventa e vitit1951) ☐ Alien's passport/ Pasaportë e huaj ☐ Seaman's passport/ Pasaportë marinari ☐ Other travel document (please specify): / Dokument tjetër udhëtimi (lutemi specifikoni):	Viza ☐ Refuzuar ☐ Aprovuar Tipi i vizës ☐ A
14. Number of passport/ Numri i Pasaportës / **15. Issued by/ Lëshuar nga**	☐ C ☐ D/
16. Date of issue / Data e lëshimit / **17. Valid until/ E vlefshme deri më**	**Numri i hyrjeve**
18. If you reside in a country other than your country of origin, have you permission to return to that country? Në rast se qëndroni në një vend tjetër nga ai i origjinës, a keni lejë kthimi në atë vend? ☐ No / Jo ☐ Yes, (number and validity) / Po, (numri dhe vlefshmëria).....	☐ një ☐ dy ☐ shumë
*** 19. Current occupation/ Punësimi aktual**	Kohqëndrimi_____
*** 20. Employer and employer's address and telephone number. For students, name and address of school. /. Punëdhënësi, adresa e punëdhënësit dhe numri i telefonit. Për studentët, emri dhe adresa e shkollës.**	E vlefshme nga_____ Deri më_____

*The questions marked with * do not have to be answered by family members of Albanian citizens or resident (spouse, child or dependent ascendant). Family members of Albania citizens have to present documents to prove this relationship.

* Pyetjet që kanë shenjën * nuk kanë nevojë për përgjigje nga pjesëtarët e familjeve të shtetasve shqiptarë ose rezident në Shqipëri (bashkëshort-i(ja), fëmija, ose paraardhësit e varur prej tyre). Pjesëtarët e familjeve të shtetasve shqiptarë duhet të paraqesin dokumente për ta provuar këtë lidhje.

21. Main destination / Destinacioni kryesor	22. Type of Visa /Tipi i Vizës : ☐ Airport transit / Transit në aeroport ☐ Transit / Transit ☐ Short stay / Qëndrim i shkurtër ☐ Long stay / Qëndrim i gjatë	23. Visa / Viza ☐ Individual / Individuale

24. Number of entries requested / Numri i hyrjeve të kërkuara: ☐ Single entry / Një hyrje ☐ Two entries / Dy hyrje ☐ Multiple entries / Shumë hyrje	25. Duration of stay / Kohëzgjatja e qëndrimit: Visa is requested for: _____ days / Viza kërkohet për: .....ditë

26. Other visas (issued during the past three years) and their period of validity/ Viza të tjera (të lëshuara gjatë tre viteve të fundit) dhe periudha e vlefshmërisë së tyre

27. In the case of transit, have you an entry permit for the final country of destination? / Në rast transiti, a keni leje hyrje për vendin e destinacionit përfundimtar?

☐ No / Jo ☐ Yes , valid until: / po , e vlefshme deri më:
Issuing authority: / Autoriteti lëshues:

28. Previous stays in Albania / Qëndrime të mëparshme në Shqipëri

29. Purpose of travel / Qëllimi i udhëtimit

☐ Tourism / Turizëm ☐ Business / Biznes ☐ Visit to Family or Friends/ Vizitë Familjes ose Miqve ☐ Cultural/Sports / Kulturore/Sportive ☐ Official / Zyrtare ☐ Medical reasons / Arsye mjekësore
